



BULETINI

Janar 2009

Numri I/2009

Permbajtja

- Seminar - civile: Risitë më të rëndësishme në Ligjin për Procedurën Kontestimore
- Seminar - penale: Shqiptimi i masave alternative në vend të dënimit me burgim
- Tryezë diskutimesh-civile: Testamenti si bazë për trashëgim
- Takimi me donatorë
- Trajnimet në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor
- Tryezë diskutimesh - penale: Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale

Seminar - civile: Risitë më të rëndësishme në Ligjin për Procedurën Kontestimore

Instituti Gjyqësor i Kosovës me datën 20 janar 2009 ka organizuar seminarin në lëmin civile me temën “Risitë kryesore në Ligjin e Procedurës Kontestimore”. Temat kryesore kishin të bënin lidhur me: Risitë e Ligjit për Procedurën Kontestimore, dallimet në mes të dispozitave të vjetra dhe atyre të reja të LPK-së si dhe mënyrën se si t’i qasen gjyqtarët në zbatim praktik të dispozitave të reja të LPK-së. Gjithashtu vëmendje e veçantë iu kushtua

vështirësive me të cilat po ballafaqohen gjyqtarët në zbatimin e dispozitave të reja ligjore në praktikë mbi procedurën kontestimore. Përfitues të këtij seminari ishin gjyqtarët e lëmis civile nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Seminar - penale: Shqiptimi i masave alternative në vend të dënimit me burgim

Më datën 26 dhe 27 janar 2009 Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Ambasadën Norvegjeze realizoi seminarin me temë ”Shqiptimi i masave alternative në vend të dënimit me burg”. Temat

prokurorit dhe gjykatës në zbatimin e masave alternative, me theks të veçantë çështjet e ndërmjetësimit.



Përfitues të trajnimit ishin: gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha regjioneve të e Kosovës si dhe zyrtar të shërbimit sprovues nga regjioni i

Prishtinës.

Zhvillim
Profesional
Gjyqësor

Tryezë diskutimesh - Civile: Testamenti si bazë për trashëgim

Më datën 28 janar 2009 është organizuar tryeza e diskutimeve në lëmin civile me temë "Testamenti si bazë për trashëgim". Çështjet kryesore të trajtuara në këtë tryezë kishin të bënin lidhur me; testamentin si bazë për trashëgim, përjashtimin nga pjesa e



domosdoshme e trashëgimisë me testament, natyrën juridike të pjesës së domosdoshme, llogaritjen e saj dhe zvogëlimin e pjesës së disponuar me testament. Vëmendje e veçantë iu kushtua trajtimit të rasteve nga praktika gjyqësore (përmes shembujve të ilustruar të

përzgjedhura nga trajnuesit. Qëllimi i kësaj tryeze ishte prezantimi i praktikave më të mira dhe përpjekja për evitimin e dilemave që po paraqiten në praktiken gjyqësore si dhe unifikimi i saj. Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët e lëmis civile nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Takim me donatorë

Me datën 29 janar 2009 i organizuar nga IGJK-ja u mbajt takimi i rregullt me donatorë. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga COE, UNICEF, USAID/NCSC, OSBE, ABA-ROL, UNDP, Departamenti i Drejtësisë i SHBA-së, Komisioni Evropian dhe përfaqësues nga EULEX-i. Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi i aktiviteteve

të donatorëve në raport të mbështetjes së IGJK-së dhe njoftimi me rrjedhën e aktiviteteve të IGJK-së. Me këtë rast të gjithë donatorët premuan që të vazhdojnë bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme për IGJK-në, në realizim të programeve trajnuese dhe aktiviteteve për vitin 2009.

Trajnimet nga Programi Fillestar për Arsimim Ligjor

Të filluara me 22 shtator 2008 trajnimet në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor në fazën e parë kanë vazhduar edhe gjatë muajit janar sipas planprogramit, kalendarit dhe orarit trajnues të parashikuar.

Trajnimet janë mbajtur tri ditë në javë në këto module: Moduli 1, Kodi Penal (pjesa e përgjithshme), Moduli 2, Kodi i Procedurës Penale (pjesa 1-2), Moduli 3, KEDNJ, Të Drejtat e Njeriut, Moduli 4,

Etikë gjyqësore, Moduli 5, Kodi Penal (pjesa e posaçme), Moduli 6, Kodi i Procedurës Penale (pjesa 3-4), Moduli 7, Trafikimi me Njerëz, Moduli 8, Shkrimi, Arsyetimi dhe Hulumtimi Ligjor, Moduli 9, Kodi i Procedurës Penale (pjesa 5-8), Moduli 10, Ligji Penal për të Mitur, Moduli 11, Krimi Financiar dhe Korrupsioni, Moduli 12, E drejta Administrative dhe Kushtetuese.

Trajnimi është vijuar nga 30 pjesëmarrës.

Tryezë diskutimesh - penale: Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale

Më datën 30 janar 2009 u realizua tryeza e diskutimeve me temë "Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale". Në kuadër të këtij sesiioni trajnues u diskutua lidhur me sqarimin e instituteve juridike si: bashkëkryerja, bashkimi kriminal, shtytja dhe ndihma.



Trajnimi po ashtu u përqendrua në vështtrimin analitik dhe eliminimin i paqartësive të cilat shfaqen në punën e përditshme të gjyqësorit.

Përfitues të trajnimit ishin: gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha regjioneve të Kosovës dhe pjesëtar të policisë së Kosovës.

Adresa: Lagja e Spitalit, Rr. "Muharrem Fejza" p.n.
Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel&fax: +381 (0) 38 512 069
+381 (0) 38 512 081
+381 (0) 38 512 095
www.kjijudicial.org
info@kjijudicial.org